



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
TIRANË

Nr. regjistrimit themeltar 2388
Data e regjistrimit 19.02.2014

Nr. i vendimit 1950
Data e vendimit 28.04.2014

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata administrative e shkallës së parë Tiranë e përbërë nga:

Gjyqtare: Elda VRIONI

Asistuar nga sekretare Geralda Bakiasi, sot më datë 28.04.2014, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen administrative me nr.2388, regjistruar më datë 19.02.2014, që i përket:

PADITËSE: Qendra “Res Publica”, me adresë: Rruga “Th. Ziko”, P.65/1, Sh.3, Ap.9, Tiranë, e përfaqësuar në gjykim nga Arbësa Kurti, e pajisur me autorizimin datë 24.03.2014, lëshuar nga drejtori ekzekutiv Dorian Matlija, **në mungesë**.

I PADITUR: Ministria e Mjedisit, me adresë: Rruga e Durrësit, nr.27, Tiranë, e përfaqësuar në gjykim nga Besmir Alushi, i pajisur me autorizim nr.4270/1 prot. datë 01.04.2014 lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse pranë Ministrisë së Mjedisit, **në mungesë**.

Në mungesë të Avokaturës së Shtetit Zyra Vendore Tiranë, përfaqësuesi i së cilës Edmond Hoxha, me shkresën datë 03.03.2014, ka paraqitur relacion për mospjesëmarrje në gjykim.

OBJEKTI: Detyrimin e të paditurit të japë informacionin dhe dokumentet zyrtare të kërkuara nga paditësi, në lidhje me a) shumën e shpenzuar nga institucioni për reklamat audiovizive, shpallje në shtypin e shkruar dhe shpenzime të tjera me natyrë publicitare për vitet 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013; dhe b) listën e shoqërive tregtare që janë kontraktuar/paguar për spotet audiovizive, përfshirë produksionin dhe transmetimin ose publikimin, si dhe shumën që i është akorduar secilit subjekti tregtar.

BAZA LIGJORE: Neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
Neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
Nenet 9/1, 10, 13/1, 14, 18/b, 20, 45/1, 51, 55, 118 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative.
Nenet 3, 7 të Ligjit Nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare”.
Nenet 31, 32/a të Kodit të Procedurës Civile.

2014-05-29

Nenet 15/a, 171/ç,f, 40/1/ç,f të Ligjit Nr.49/2012, datë 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Gjykata konstaton kryesisht se çështja bën pjesë në juridiksionin e saj gjyqësor në bazë të nenit 36 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe se në bazë të neneve 7, germa "b" dhe 11, pika 1 të ligjit 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", ajo ka kompetencën lëndore dhe tokësore për gjykimin e çështjes.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes të zhvilluar në mungesë të palëve, gjykata, pasi shqyrtoi provat e marra dhe u konsultua me ligjin lidhur me këtë çështje,

V Ë R E N

Me datën 19.02.2014 është regjistruar për gjykim pranë kësaj gjykate, kërkesëpadija e palës paditëse Qendra "Res Publica" me të paditur Ministria e Mjedisit, duke kërkuar gjyqësisht kërkimet e parashtruara në kërkesëpadi.

Sipas të dhënave nga aktet shkresore të paraqitura, rezulton në kronologji kohore, se:

Pala paditëse Qendra "Res Publica" është person juridik i së drejtës shqiptare, organizatë jofitimprurëse, e regjistruar me vendimin Nr.604, datë 13.04.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me datën 16.10.2013 subjekti paditës ka paraqitur një kërkesë fillestare pranë Ministrisë së Mjedisit, për kërkimin e informacionit dhe vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare, që lidhen me:

- a) shumën e shpenzuar nga institucioni për reklamat audiovizive, shpallje në shtypin e shkruar dhe shpenzime të tjera me natyrë publicitare për vitet 2009 deri 2013; dhe
- b) listën e shoqërive tregtare që janë kontraktuar/paguar për spotet audiovizive, përfshirë produksionin dhe transmetimin ose publikimin, si dhe shumën që i është akorduar secilit subjekti tregtar.

Kjo kërkesë, shoqërohet nga dëftesa postare për komunikimin e saj e datës 17.10.2013.

Me kalimin e afatit 15 ditor për paraqitjen e arsyeve të mospranimit të kërkesës nga ana e palës së paditur, pala paditëse Qendra "Res Publica" ka pritur edhe kalimin e afatit 40 ditor për kthimin e përgjigjes për kërkesën e parashtruar palës së paditur.

Pasi nuk është kthyer përgjigje, pala paditëse e ka konsideruar këtë veprim refuzim të pranimit të kërkesës së paditësit dhe për pasojë me datën 27.11.2013 ka paraqitur një ankim administrativ tek organi epror. Ankimi shoqërohet nga dëftesa postare për komunikimin e saj e datës 02.12.2013.

Pala paditëse pretendon se ka kaluar afati një muaj për t'iu përgjigjur ankimit administrativ dhe organi publik nuk ka kthyer asnjë përgjigje. Afati sipas saj ka mbaruar me datën 02.01.2014.

Paditësi, i është drejtuar gjykatës, duke kërkuar në padi kërkimet e tij ligjore duke parashtruar se:

- Pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin. Transparenca e dokumenteve zyrtare është e padiskutueshme dhe çdo organ publik është i detyruar të japë informacionet e kërkuara,

brenda afateve ligjore dhe në mënyrën e kërkuar nga kërkuuesit. Pala e paditur nuk ka vepruar brenda afateve, duke refuzuar dhënien e informacionit të kërkuar.

- Pala e paditur nuk ka paraqitur asnjë shkak ligjor për refuzimin e informimit. Nëse ka shkaqe të bazuara në ligj për të refuzuar kërkesën për informim, afati i marrjes së një vendimi të tillë është 15 ditë. Në rastin konkret, pala e paditur nuk ka marrë dhe komunikuar asnjë vendim për refuzimin e dhënies së informacionit, të bazuar në ndonjë shkak të vlefshëm.
- Pala e paditur nuk është përgjigjur brenda afatit ligjor. Afati ligjor ndaj kërkesave për informacion është 40 ditë. Brenda këtij afati paditësi nuk ka kthyer asnjë përgjigje, heshtje kjo e cila konsiderohet si refuzim për pranimin e kërkesës.
- Pala e paditur ka mohuar të drejtën për informim, si një nga të drejtat themelore që qëndrojnë në bazë të një shoqërie demokratike. Transparenca dhe e drejta e informimit rregullohet nga një sërë dispozitash si neni 23 i Kushtetutës, neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenet 13/1, 51, 52, 54, 55 të Kodit të Procedurës Administrative, nenet 1/2/dh, 2, 12, 21, 25, 52, 57/1 të Ligjit Nr.9463, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, Konventa e KE mbi Aksesin në Dokumentet Zyrtare (CETS 205), neni 19 i Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, neni 19.1.b i Ligjit Nr.8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil”, neni 22 i Kodit Europian të Sjelljes së Mirë Administrative si dhe një sërë vendimesh të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe gjykatave shqiptare.

Pala e paditur nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar u paraqit në gjykim në seancën gjyqësore të datës 24.04.2014, por se nuk dha asnjë argument lidhur me sa kërkohet në padi.

Nga sa pretendohet në padi dhe provohet nga aktet shkresore të paraqitura në gjykim, gjykata analizon si më poshtë:

Së pari: çështja gjendet e trajtueshme nga kjo gjykatë në kushtet kur mosmarrëveshja ka lindur që lindin për shkak të mosveprimit të organit publik, sipas nenit 7, germa ‘b’ të ligjit 49/2012.

Së dyti: pala paditëse provon interesin e saj të ligjshëm në padinë e paraqitur, sipas nenit 15, germa ‘a’ të ligjit 49/2012 me pretendimi se i është cenuar e drejta e ligjshme për tu informuar nga mosveprimi i organit publik.

Së treti: subjekti paditës i është drejtuar gjykatës pasi ka paraqitur ankimin në rrugë administrative pranë Ministrit, më datë 27.11.2013 dhe i është drejtuar gjykatës brenda 45 ditëve pas përfundimit të afatit ligjor për marrje të përgjigjes (në përputhje me nenin 18, pika 1, germa ‘dh’ të ligjit 49/2012).

Së katërti: në thelb të padisë qëndron pretendimi i paditësit për të marrë informacion dhe dokumentet zyrtare nga një organ publik, në rastin konkret nga Ministria e Mjedisit.

Sipas nenit 23, pika 2 të Kushtetutës së RSH: **‘Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore’**. Në ligjin nr.8503 datë 30.6.1999 ‘Për të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare’, neni 3 i njeh të drejtën çdo personi të kërkojë informacion për dokumentet zyrtare, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e organeve shtetërore dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet e kërkesës. Neni 7 i këtij ligji, përcakton se kërkuuesit i vihet në dispozicion një kopje e plotë e dokumentit zyrtar, për të cilin kërkon të informohet.

Sipas nenit 10 të ligjit 8503/1999, autoriteti publik ka të drejtën të vendos për mospranimin e plotë ose të pjesshëm të kërkesës brenda 15 ditëve nga depozitimi i saj, ndërsa kur nuk ka shkak për refuzim, përgjigja duhet të jepet brenda 40 ditëve nga depozitimi (neni 11 i ligjit). Në raste të

caktuara, autoriteti mund të kërkojë shtyrjen e afatit, por se kjo mundësi duhet t'i bëhet me dije subjektit pa mbaruar afati ligjor në dispozicion.

Në rastin konkret, me të drejtë pala paditëse pretendoi se në asnjë nga dy aktet e depozituara prej tij nuk ka marrë përgjigje brenda afatit, qoftë edhe negative për mospranim të dhënies së informacionit, arsye pse pala paditëse i është drejtuar gjykatës. Nëse ka shkaqe ligjore të cilat justifikojnë mosdhënien e informacionit, organi publik ka detyrimin të shprehet me vendim refuzimi, në të kundërt duhet të japë informacionin zyrtar, siç e kërkon ligji.

Gjykata, në kushtet e mosparaqitjes së argumenteve nga pala e paditur, vlerëson se ajo ka detyrimin me ligj të shprehet lidhur me kërkesën e paraqitur nga subjekti paditës për dhënie të informacionit dhe vënie në dispozicion të dokumenteve zyrtare. Gjykata i referohet këtu nenit 26, pika 3 të ligjit 49/2012 i cili thotë shprehimisht se: *'Në rast se organi publik nuk i paraqet provat deri në datën e seancës gjyqësore, atëherë gjykata, duke vlerësuar provat e tjera dhe rrethanat e çështjes, mund të konsiderojë të provuar faktet e pretenduara nga pala tjetër, për provimin e të cilave janë kërkuar këto prova'*.

Në kushtet kur pala e paditur nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për refuzim të dhënies së informacionit apo dhënien e tij brenda afatit ligjor, gjykata, në referim të dispozitave specifike të ligjit nr.8503 datë 30.6.1999 'Për të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare', si dhe nenit 40/ç të ligjit 49/2012, për mundësinë e detyrimin e organit publik për të kryer një veprim administrativ, për të cilin organi publik ka heshtur, ndonëse ka pasur kërkesë, e gjen të drejtë padinë duke vendosur: detyrimin e Ministrisë së Mjedisit për tu shprehur lidhur me kërkesën për dhënien ndaj palës paditëse Qendra 'Res Publica' të informacionit dhe dokumenteve zyrtare lidhur me: a) shumën e shpenzuar nga institucioni për reklamat audiovizive, shpallje në shtypin e shkruar dhe shpenzime të tjera me natyrë publicitare për vitet 2009 deri 2013; dhe b) listën e shoqërive tregtare që janë kontraktuar/paguar për spotet audiovizive, përfshirë produksionin dhe transmetimin ose publikimin, si dhe shumën që i është akorduar secilit subjekti tregtar.

Gjithashtu, për qëllime të realizimit të të drejtave të paditësit e njëkohësisht për të evituar vonesat në ekzekutim, gjykata në zbatim të nenit 41 të ligjit 49/2012, vendos që ekzekutimi i këtij vendimi, duhet të behet nga subjekti i paditur pasi vendimi të marrë formë të prerë, në kohën kur kërkohet ekzekutimi i tij nga pala paditëse.

Lidhur me shpenzimet gjyqësore, të evidentuara gjatë gjykimit, ato janë në ngarkim të palës së paditur sipas nenit 106 të Kodit të Procedurës Civile dhe përbëhen nga tarifa për ngritjen e padisë në masën 12.000 lekë.

P Ë R K Ë T O A R S Y E

Gjykata, mbështetur në nenet 3 dhe 7 të ligjit nr.8503 datë 30.6.1999 'Për të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare', dhe nenet 40/ç dhe 41 të ligjit 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"

V E N D O S I


1. Pranimin e padisë së palës paditëse Qendra 'Res Publica'.

Shpallimin e Ministrisë së Mjedisit për tu shprehur lidhur me kërkesën për dhënien ndaj palës paditëse Qendra 'Res Publica' të informacionit dhe dokumenteve zyrtare lidhur me: a) shumën e shpenzuar nga institucioni për reklamat audiovizive, shpallje në shtypin e shkruar dhe shpenzime të tjera me natyrë publicitare për vitet 2009 deri 2013; dhe b) listën e shoqërive tregtare që janë kontraktuar/paguar për spotet audiovizive, përfshirë produksionin dhe transmetimin ose publikimin, si dhe shumën që i është akorduar secilit subjekti tregtar.

3. Ekzekutimi i këtij vendimi do të bëhet nga pala e paditur pasi ky vendim të marrë formën e prerë, në kohën kur kërkohet ekzekutimi i tij nga pala paditëse.
4. Shpenzimet gjyqësore dhe ato në fazën e ekzekutimit të vendimit, janë në ngarkim të palës së paditur.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.

- U shpall në Tiranë, sot më datë 28.04.2014

SEKRETARE
GERALDA BAKIASI



SHPENZIME GJYQËSORE
Tarife padie 3.000 lekë

GJYQTARE
ELDA VRIONI

